



22 shtator 2012, Prizren

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Të ndalet praktika e investimeve publike në pronat e kontestuara

Në kuadër të monitorimit të punës së ekzekutivit të komunës së Prizrenit, EC Ma Ndryshe brenda muajit shtator është angazhuar edhe në shqyrtimin e investimeve të përbashkëta që realizohen në partneritet ndërmjet qeverisë qendrore dhe asaj lokale. EC Ma Ndryshe gjatë hulumtimeve të bëra ka hasur në një rast, i cili është shqetësues për arsye se paratë publike investohen në një hapësirë, e cila vazhdon të jetë subjekt i kontestit pronësor, tani në shqyrtim në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Fjala është për projektin - Krijimi i Kushteve për Zhvillim të Turizmit dhe Mbrojtjes së Ambientit, nëpërmes ndërtimit të vend Piknikut në komunën Prizren – ku palë nënshkruese janë Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe komuna e Prizrenit, dhe i cili projekt ka nisur së zbatuari në vendin e quajtur “Brione”, pavarësisht nga fakti se Gjykata komunale dhe ajo e Qarkut të Prizrenit kanë vlerësuar se prona ku kanë nisur punimet i takon familjeve Dehiri-Hapçiu.

Në marrëveshjen e mirëkuptimit ndërmjet MAPL-së dhe komunës së Prizrenit thuhet se për ndërtimin e vend piknikëve në Prizren, Dragash e Mamushë, MAPL-ja do të investoj 89 mijë e 850 euro. MAPL ka nënshkruar kontratë me dy operatorë ekonomikë për ndërtimin e këtyre hapësirave. Komuna e Prizrenit, drejtorja për Kadastër ka nxjerrë Certifikatën mbi të drejtat e pronës sipas së cilës pronar është komuna e Prizrenit. Drejtorja e Urbanizimit ka njoftuar se kjo zonë është brenda Planit Zhvillimor Urban të Prizrenit, porse nuk ka Plan Rregullues Urban për këtë pjesë.

Mirëpo Gjykata Komunale në vitin 2008 pat vlerësuar se prona në “Brione” i takon familjeve Dehiri-Hapçiu, gjë që është konfirmuar edhe me aktgjykim të Gjykatës së Qarkut të Prizrenit, më 11 shtator 2009. Në aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut thuhet se “gjykata ka gjetur që aktgjykimi i shkallës së parë është i bazuar dhe me ligj i themeluar”.

“Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të padyshimtë ka vërtetuar se patundshmëria në fjalë ka qenë pronë e paraardhësit të paditësve dhe prona e tyre pa ndonjë veprim juridik dhe pa procedura administrative, përveç me regjistrim të njëanshëm regjistrohet si pasuri shoqërore. Në regjistrat kadastrale nuk ekziston asnjë akt apo vendim juridik i cili do të justifikonte këtë regjistrim”, thuhet në këtë aktgjykim, ku po ashtu kërkohet respektimi i dispozitave të Ligjit mbi marrëdhëniet pronësore, konventa e Këshillit Evropian dhe deklarata universale e të drejtave të njeriut. Gjykata e Qarkut e ka bërë të qartë se “regjistrimi në fletëposedim nuk është provë mbi posedimin” dhe se në esencë “komuna paraqitet si uzurpues i pasurisë së huaj”.

Mirëpo avokati publik i komunës ka kërkuar revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës në nëntor të vitit 2009, duke atakuar në tërësi aktgjykimin e Gjykatës së qarkut të Prizrenit dhe të asaj komunale. Vendimet e dy gjykatave janë kundërshtuar edhe nga Prokuroria e Shtetit, e cila ka theksuar se për administrimin e pasurisë shoqërore është kompetente AKM-ja (tani AKP-ja).

Në anën tjetër Gjykata Supreme deri më tani nuk ka dal me një vlerësim, që len të kuptohet se çështja e pronësisë në “Brione” vazhdon të mbetet pezull. Përkundër kësaj komuna e Prizrenit me mjetet e MAPL-së gjatë verës ka nisur së ndërtuari vend piknikun, ndërkohë që më 1 gusht 2012 Gjykata Komunale me aktvendim ka caktuar masën e përkohshme për ndalimin e punimeve. Një gjë e tillë nuk është respektuar nga komuna e Prizrenit dhe punimet kanë vazhduar.

Duke i marrë për bazë të gjitha faktet e sipërpërmendura EC Ma Ndryshe konsideron se si qeveria lokale e Prizrenit ashtu edhe Qeveria e Kosovës – MAPL duhet të respektojnë vendimet e gjyqësorit, me qëllim të ndërtimit të shtetit ligjor. EC Ma Ndryshe konsideron se para fillimit të ndërtimit të vend piknikut komuna e Prizrenit është dashur që të arrij marrëveshje me familjet Dehiri-Hapçiu, në mënyrë që të mos rrezikohet dhe humbet investimi i parave publike.

EC Ma Ndryshe gjithashtu potencon se qeveria lokale është dashur që të shter të gjitha mundësitë ligjore para se të orientonte paratë publike në një hapësirë që ka kontest pronësor. Gjithashtu është esenciale që ky rast të shërbej si shembull për mos përsëritjen e praktikave të tilla në të ardhmen, që në fund mund të rezultojnë me humbjen e parave nga fondet publike sikurse edhe të lëkundet besimit në institucionet e pushtetit lokal dhe atij gjyqësor.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, www.online-transparency.org.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Ismet J. Kumanova, Nr. 31 - Prizren
Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy
Pristina

Projekti “Transparenca online e komunës së Prizrenit” prej muajit shtator 2012 përkrahët financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.